

AKT THEMELIMI
Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“I.M.K” SH.P.K.

Sot, më datën 25.09.2023, **Znj. Miranda Shaba** e lindur në Durrës, Shqipëri më datë 03 mars 1965 mbajtëse e leternjoftimit elektronik me numër personal G55303250A, banuese në Durrës, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **“I.M.K” Sh. P. K.** si më poshtë vijon

Neni 1

Personi fizik i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.) me emërtimin **“I.M.K” shpk.**

Ortak i kësaj shoqërie është **Znj. Miranda Shaba.**

Administratore e kësaj shoqërie caktohet **Znj. Miranda Shaba**, shtetase shqiptare, lindur në Shqipëri më 03 mars 1965, e pajisur me NID nr. G55303250A. Znj. Shaba emerohet administratore e shoqërisë për një periudhë 5 vjetecare.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqëria **“I.M.K” shpk** gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“Sh.P.K.”**. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë **“I.M.K” SH.P.K.** është: **Durrës, Rruga Taulantia, numri i pasurisë 25/329, zona kadastrale 8512.**

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Nderime civile dhe ekonomike, industriale turistike, bujqesore deri në 5 kate dhe mbi 5 kate, rikonstrukcione, ndërtim banesash me skelet mbi 8 kate, Nderime rrugore kategoria IV dhe V, III dhe II , autostrada – pista
- Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, punime speciale të shinave dhe traversave, në sistemin elektrik dhe të sinjalizimit
- Nderime hidraulike e hidroteknike, ujësjelles, kanalizime, kanale e impiante vaditje, punime mbrojtje të sistemit hidraulik-cimentime, impiante të sistemit të ujit, vajsjelles, gazsjelles, naftesjelles, diga-damba deri në 10m, galeri tunele, diga të larta. Vepra të vecanta punime speciale, sillose, kulla uji etj. B/arme metalike, perforcime themeli e punime nentokesore, izolime mbi dhe nentokesore nga ujrat, themele të vecanta, puse shpime gjeologjiko- inxhinierike, çpime për ujë.
- Punime karpenterie, shërbimi , në sipërfaqe të gjelberta

- Prodhim asfalti, betoni, parafabrikate betoni. Projektim ne fushen e ndertimit.Veprimtari e ekspertizes ndikimin ne mjedis
- Dhenie me qira. Vleresim te pasurive te paluajtshme
- Transport mallrash dhe pasagjeresh brenda dhe jashte vendit per llogari te vet dhe te trete.Transport me mjete te vecanta jashte normes

Kapitali i shoqerise eshte 1.000.000 Leke. Kapitali i shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri ku cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera si me poshte:

- **Znj. Miranda Shaba** zotëruese e një kuote me vlerë të përgjithshme 1.000.000 leke që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta). Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 6

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

Neni 8

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Miranda Shaba

Miranda Shaba

Miranda Shaba